

## PARASHIKIMI I RREZIKUT NGA PËRMBYTJET

-----

Gjatë ditës së nesërme (e martë, dt.29) pritet të ketë reshje me intensitet të lartë, të cilat do të jenë më të përqëndruara në veri dhe në jug të territorit. Në qarqet Shkodër, Lezhë, Durrës, Tiranë, Fier dhe Vlorë mund të ketë vërshime të shpejta të lumenjve të vegjël malorë dhe rrëshqitje të dherave. Në zonat urbane, në këto qarqe mund të shfaqen probleme me përmbytje të lokalizuara, në varësi të gjendjes së kanalizimeve.

## PARASHIKIMI METEO

-----

### RESHJET

Sot pasdite (e hënë, dt.28) priten reshje të dobëta në qarkun e Shkodrës.

Nesër (e martë, dt.29) priten reshje intensive në qarqet Shkodër, Lezhë, Durrës, Tiranë, Fier dhe Vlorë, ndërsa mesatare në shumicën e qarqeve të tjera të vendit. Reshjet do të shoqërohen edhe me shtrëngata në pothuajse të gjitha qarqet (siç tregohet në tabelë, respektivisht për secilin qark).

### TEMPERATURAT

Nesër (e martë, dt.29) temperaturat minimale dhe maksimale të ajrit pritet të arrijnë:  
në bregdet: 23 / 34°C; në vendet e ulëta: 20 / 28 °C; në vendet malore: 16 / 25 °C

### ERA

Sot pasdite (e hënë, dt.28) dhe nesër (e martë, dt.29) era pritet të jetë mesatare deri e fortë, sidomos në bregdet.

## ZJARRET NË PYJE

-----

Sot pasdite (e hënë, dt.28) pritet niveli rrezik " I LARTË" në qarqet Tiranë dhe Fier, ndërsa në qarqet e tjera pritet niveli rrezik i "I MODERUAR". Nesër (e martë, dt.29) pritet niveli rrezik "I MODERUAR" në qarqet Berat, Fier, Gjirokastër, Korçë dhe Kukës. Në qarqet e tjera "S'KA RREZIK" (siç tregohet në tabelë, respektivisht për secilin qark).

**NIVELET E RREZIKUT**

**S'KA RREZIK**

**I ULËT**

**I MODERUAR**

**I LARTË**

**BULETINI MBI RREZIQET NATYRORE** (Bulletin on Natural Hazards)
























Qendra Kombëtare për Parashikimin dhe Monitorimin e Rreziqeve Natyrore

Facebook page : Instituti i Gjeoshkencave, Webpage: [www.geo.edu.al](http://www.geo.edu.al)

Buletini Nr. 220/ 2023, 28-08-2023

Parashikimi nga 28-08-2023, ora 12:00 deri më 29-08-2023, ora 23:59.

**PARASHIKIMI I DETAJUAR MBI RREZIQET NATYRORE (SOT DHE NESËR)**

| RREZIKU MAKSIMAL<br>I QARKUT | Zjarre<br>në pyje                | Ngjarje<br>Meteorologjike                    |  |   | Ngjarje<br>Hidrologjike   |                       |   |
|------------------------------|----------------------------------|--|--|---|---|-----------------------|---|
|                              | Zjarret<br>Mesatarja<br>e qarkut | Reshje<br>24-orëshe<br>Mesatarja<br>e qarkut | Reshje<br>24-orëshe<br>Maksimale<br>të lokalizuara | Shtrëngata  | Përmbytje<br>të<br>Shpejta  | Përmbytje<br>Lumenjsh | Rrëshqitje<br>toke  |
| SHKODËR                      | I MODERUAR                       | intensive                                    |  |    |    |                       |    |
| KUKËS                        | I MODERUAR                       | mesatare                                     |  |    |   |                       |   |
| DIBËR                        | I MODERUAR                       | mesatare                                     | intensive  |    |   |                       |   |
| LEZHË                        | I MODERUAR                       | intensive                                    |  |    |    |                       |    |
| DURRËS                       | I MODERUAR                       | intensive                                    |  |    |    |                       |    |
| TIRANË                       | I LARTË                          | intensive                                    |  |    |    |                       |    |
| ELBASAN                      | I MODERUAR                       | mesatare                                     |  |    |   |                       |   |
| FIER                         | I LARTË                          | intensive                                    |  |  |  |                       |  |
| BERAT                        | I MODERUAR                       | mesatare                                     |  |  |   |                       |   |
| KORÇË                        | I MODERUAR                       | të dobëta                                    |  |   |   |                       |   |
| VLORË                        | I MODERUAR                       | intensive                                    |  |  |  |                       |  |
| GJIROKASTËR                  | I MODERUAR                       | mesatare                                     |  |  |   |                       |   |





**LEGJENDA: Reshjet 24-orëshe**


| <b>Niveli i Rrezikut</b> | <b>Reshje shiu</b><br>(mm / 24 orë)  |
|--------------------------|--|
| S'KA RREZIK              | të dobëta (0 – 15 mm / 24 orë)<br>Nuk priten fenomene hidro-meteorologjike problematike.   |
| I ULËT                   | mesatare (15 – 45 mm / 24 orë)<br>Mundësi që të shfaqen fenomene hidro-meteorologjike problematike.  |
| I MODERUAR               | intensive (45 – 90 mm / 24 orë)<br>Moti parashikohet i rrezikshëm.<br>Parashikohen fenomene të pazakonta hidro-meteorologjike.                     |
| I LARTË                  | shumë intensive (> 90 mm / 24 orë)<br>Moti është shumë i rrezikshëm.<br>Parashikohen fenomene të pazakonshme hidro-meteorologjike mjaft intensive. |

**LEGJENDA: Zjarre në pyje**

|             |   |
|-------------|---|
| S'KA RREZIK | Zjarret e mundshëm janë të kontrollueshëm lehtësisht.   |
| ULËT        | Barërat e thatë dhe pyjet mund të digjen lehtë. Flakët janë të mesme në pyje dhe të shpejta në zonat e ekspozuara.  |
| I MODERUAR  | Ndezja e zjarreve mund të ndodhë lehtë dhe me përhapje të shpejtë. Zjarret mund të jenë shumë të nxehtë, me kurora përhapje të vogla dhe të mesme.                          |
| I LARTË     | Ndezja mund të shkaktohet edhe nga një shkëndijë. Zjarret janë shumë të nxehtë me përhapje shumë të shpejtë të flakëve si rrjedhim kontrolli i tyre është shumë i vështirë. |

**SIMBOLE**

|   |  |
|---|--|
|  | Shtrengata: reshje mbi 20 mm/3orë. Moti mund të krijojë probleme të ndryshme |
|  | Përmytje urbane ose nga përrrenjtë dhe lumenjtë e vegjël                     |
|  | Përmytje nga lumenjtë e mesëm dhe të mëdhenj                                 |
|  | Rrëshqitje toke  |



**RREZIKU MAKSIMAL I QARKUT për sot dhe nesër, dt. 28 – 29.**